



Oda e Avokatëve të Kosovës
Kosova Chamber of Advocates
Advokatska Komora Kosova



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të

ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

dhe të

FAKULTETIT JURIDIK,
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

P R I S H T I N Ë
2 Qershor 2010

Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, lidhin këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

A. FORMAT E BASHKËPUNIMIT:

I. Palët [Oda e Avokatëve të Kosovës-më tutje “OAK”] dhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës - më tutje “Fakulteti”] do të zhvillojnë format e bashkëpunimit në fushëveprimin e vet.

Për këtë qëllim ata do të ndërtojnë lidhje të qëndrueshme në shkëmbimin e ekspertizës, përvojës dhe resurseve të përbashketa.

II. Palët do të mbështesin projektet reciproke, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta dhe bashkarisht do të realizojnë projekte nga fusha e këtij Memorandumi.

III. Palët gjithashtu do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit midis entiteteve rajonale të shërbyesve ligjorë.

Veçanërisht do të inkurajohet bashkëpunimi i jashtëm me organizatat nga fusha e edukimit të të drejtave të njeriut.

Oda dhe Fakulteti pajtohen që të formojnë një Grup të përbashkët i cili do të ketë detyrë që t'i identifikojë dhe zbatojë format e këtij bashkëpunimi.

IV. Palët do të bashkëpunojnë edhe në fushën e aftësimit dhe përgatitjes së juristëve të rinj për ushtrimin e profesionit ligjor/studentëve, praktikantëve dhe avokatëve të rinj.

V. Në mënyrë specifike Fakulteti do t'i ofrojë Odës mbështetje për realizimin e këtyre programeve:

- a. Programit për aftësimin e praktikantëve të avokatisë (3 eksperte: fusha penale, civile, komerciale)
- b. Programit për Arsimimin Intensiv Ligjor për Avokatët e Rinj (4 ekspertë: shkrimi ligjor, civile, penale, të drejtat e njeriut)
- c. Programin për Avokatet e Çështjeve Komerciale (lëmia e punës, arbitrazhi, marka tregtare, të drejtat e autorit)
- d. Specializimit të avokatëve
-Ekspertët për certifikimin e komisionit: 2 muaj angazhim të 7 ekspertëve)
-ekspertë të lëmise: penale, civile, komerciale, administrative, punës)
- e. Realizimit të programit te Qendrës Trajnuese (3 eksperte), si dhe
- g. Një përfaqësues i Fakultetit Juridik/dekani ose prodekani) do të jetë pjesë përbërëse e Bordit të Qendrës Trajnuese për Avokatë [QTA]

VI.

Oda do të ofrojë Fakultetit Juridik:

- a. Aftësim praktik për studentet e vitit të tretë nga 11 studentë çdo 3 muaj:
-2 në Administratën e Odes,
-6 nëpër Komitetet dhe
-4 në organet disiplinore (Zyra disiplinore),
- b. Studente (niveli i masterit) do te shërbejnë ne Qendrën e Ndihmës së Parë Juridike të OAK,
-se paku 3 studente nën mbikëqyrjen e avokatit
- c. Shpërblimi për ESSE-n më të mirë në lidhje me profesionin ligjor, për të gjithë studentet e drejtësisë do të shpërblehen tri punimet më të mira: me të holla (250€, 200€ dhe 150€, si dhe do të publikohen në Buletinin e Odës. Përzgjedhjen do ta bëjë Komisioni i veçantë: anëtarë të Odës (3), të Fakultetit (1), gjyqtare (2), ekspert të pavarur(1)
- d. Ekspertët e Odës do të marrin pjesë në zhvillimin e Mësimit Klinik, Programeve të Etikës Profesionale dhe Zhvillimin e shkathtësive praktike për studentët e drejtësisë.

B. IMPLEMENTIMI:

- I. Ky Memorandum fillon të implementohet nga palët nënshkruese në ditën e nënshkrimit.
- II. Palët zotohen që në afatin prej 7 ditësh do te emërojnë nga 3 (tre) anëtarë ne Grupin nga pika 3.c e këtij Memorandumi

C. NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI:

- I. Memorandumi hyn në fuqi dhe i obligon palët në momentin e nënshkrimit nga të dy palët.
- II. Palët detyrohen t'i përmbushin obligimet që dalin nga ky Memorandum.
- III. Memorandumi është e përpiluar në dy ekzemplarë me përbajtje të njëjtë, prej të cilave, pas nënshkrimit dhe protokolimit, nga një ekzemplar për secilës palë.
- IV. Me autorizim që të pranojnë përgjigjësitë dhe të nënshkruajnë këtë Memorandum.

Nënshkuar në Prishtinë,

Datë: 02/06/2010

Në emër të:
Odës së Avokatëve të Kosovës,
Prishtinë

Musa Xh. Dragusha, Kryetar

Në emër të:
Fakultetit Juridik
të Universitetit të Prishtinës

Dr.sc. Bajram Uka, Dekan